



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 14.9.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Liburn Aliu, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga Ministria e MMPH dhe MB, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media, përfaqësuesi nga Bordi i Mjedisit-Sylejman Berisha dhe përfaqësuesit nga Komunitat.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Dëgjimin publik e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë takim u propozua ky rend dite:

1. Dëgjimi publik për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Tokën Bujqësore

Kryetari Nait Hasani falënderoj pjesëmarrësit për përgjigje në ftesën e komisionit rreth Ligjit për Tokën Bujqësore përkatësisht zbatimin e tij dhe pas prezantimit të tyre veç e veç, ai shkurtimisht njoftoi për aktivitetin e grupit punues rreth mbikëqyrjes së ligjit në fjalë duke vizituar disa komuna, institucione etj dhe rezultatet fatkeqësisht të pakëndshme për tokën bujqësore, sidomos për tokat nën komasacion. Në fakt grupi punues ka hasur në shkelje të Ligjit për Tokën Bujqësore rezultat i së cilës është humbja afër 1000 ha në Kosovë çdo vit të tokës bujqësore, çka do të thotë se në 10 vite të ardhshme mund të presim betonimin e tokave pjellore.

Nijazi Idrizi (kryesues i GP për këtë ligj) u bashkëngjiti brengave të shprehura nga kryetari dhe shtoi se mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji ka qenë sfidë e veçantë për komisionin ngase është i rëndësishë së veçantë ndërsa në anën tjetër ka pasur reagime shqetësuese. GP ka hartuar pyetësorin për komuna, AKP, Agjencinë Kadastrale, Fakultetin e Bujqësisë, Institutin e bujqësisë në Pejë dhe institucionet tjera në bazë të ligjit në fjalë i cili ligj bashkëvepron me ligjet siç janë për vetëqeverisjen lokale etj. Sfidat kanë qenë disa (uzurpimet, ndarjet e tokave bujqësore etj) dhe ato kanë ndikuar në fitimin e pasqyrës për zbatimin e këtij ligji në nivelin komunal dhe qendrorë. Përgjigjet nga 16 komunat kanë qenë hamendëse, vazhdoi, sigurisht për shkak të përkeqësimit të vazhdueshëm të gjendjes me tokat bujqësore, ndaj i luti pjesëmarrësit të jenë të

hapët në diskutimet e tyre. Komisioni në vazhdim do të paraqet rekomandimet për Kuvendin e Kosovës duke mos i fshehur emrat e tyre që nuk kontribuojnë në zbatimin e këtij ligji, përfundoi. **Nait Hasani** në vazhdim potencoi faktin se gjatë punës së GP pyetja kryesore sfiduese ka qenë ndalimi i destinimeve të tokës bujqësore përkatësisht neni 15 i cili përcakton se ndërtimet në këto toka mund të bëhen vetëm në raste të veçanta për objekte me rëndësi publike, për çka komunat janë përgjegjgur solid mirëpo në terren ka qenë gjendja krejt ndryshe, me plot uzurpime (ai ceku shembullin në Gjakovë, Rahovec, Vushtrri etj) dhe objekte të cilat asnjëra nuk kanë leje të punës. Komunat në këtë drejtim janë treguar plotësisht të papërgjegjshme, inspekcionet nuk veprojnë. Ai sugjeroi që debati të fokusohet në pyetjen si më tutje, çka mund të bëjmë në këto 10 vite vijuese. Gjithashtu është konstatuar se komunat nuk kanë ndarë buxhet për funksionimin e inspekcioneve, ndërsa ligji ju lejon këtë shërbim në favor të mbrojtjes së tokës bujqësore.

Shefki Zeqiri tha se për këtë ligj janë hartuar 6 akte nënligjore dhe ligji vazhdon të zbatohet nga viti 2006 me trendët normale, mirëpo sfida është në bashkëpunimin e komunat të cilat duhet të janë më kooperative në marjen e masave. Sa i përket destinimit të tokës bujqësore, për këtë leje jep pëlqimin ministria e bujqësisë, por nuk do të thotë se kjo obligon komunën ta jap lejen, sidomos për kategoritë e tokave prej një deri katërtën klasë.

Përfaqësuesi i Klinës konstatoi se natyrën e shkatërrimë ne vet. Në Klinë afër lumit p.sh. në 28 km kemi 28 separacione, lejet epen në Ministri ngase komunat nuk kanë kompetenca (reagoi **Shefki Zeqiri** se këto leje i jep MMPH), ndaj ai ishte i mendimit se Kosova në vit i humb jo 1000 por 2000 ha tokë bujqësore. Gjithashtu shtoi se në Klinë asnjë hektarë nuk rikultivohet. **Afërdita Berisha** gjithashtu potencoi çështjen kush i jap lejet afër lumenjve. **Nait Hasani** pyeti përfaqësuesin pse dallohen shënimet nga kjo komunë nga konstatimet këtu, për çka ai tha se ministria i ka lejuar ato destinime.

Përfaqësuesi nga Vushtrria u pajtua se kjo komunë ka probleme me komasacion, mirëpo fajtohet është komuniteti i biznesit për çka zyrtarët komunal stagnojnë dhe janë në pamundësi për të vepruar, sidomos nëse kemi parasysh mosfunksionimin e gjykatave. Ai propozoi që ky komision bashkë me institucionet tjera qendrore të rekomandojnë si të veprohet nëpër komuna në mënyrë që ato mos të jenë faktorë stagnues. **Nait Hasani** pyeti rreth konstatimeve në përgjigjet nga kjo komunë, ndërsa përfaqësuesi tha “çka me bo na nëse vjen dikush me një milion në dorë për me investua kur e dimë se efekti është pozitiv (punësimi)”. Ndërhyri **Nijazi Idri**zi i cili tha se konstatimi i përfaqësuesit nuk qëndron ngase plani zhvillimor (nga viti 2009) është ai që përcakton kahet e ndërtimeve, **përfaqësuesi** reagoi dhe tha se është punuar sipas planit mirëpo ky plan nuk është i harmonizuar me ligjin në fuqi. **Nait Hasani** gjithashtu nuk u pajtua me përfaqësuesin ngase komuna është ajo që duhet të siguroi zonën industriale për investues të ndryshëm. **Shefki Zeqiri** konstatoi se një plan nuk mund të devijoj nga Ligji, mirëpo komunat duhet më tepër me pas bashkëpunim me ministrinë. Përfaqësuesi nga Vushtrria në fund kërkoi të rregullohet çështja e mungesës së të dhënave, fletëparaqitjeve në gjykata dhe të harmonizohen mekanizmat e veprimtimit në mes komunave dhe ministrisë.

Përfaqësuesi nga Lipjani tha se komuna e tij është një rrafshinë ku ka mjaft tokë pjellore me 4 kategori, por bizneset janë ato që momentalisht ngatërrojnë zbatimin e ligjit në fjalë, ata bëjnë kërkesa dhe ato zhargiten por në fund përfundojnë negativisht për tokën bujqësore, objektet ndërtohen nëpër vende më të rrafshëta, në magjistrale etj. Në pyetjen e kryetarit pse komuna jap leje, tha se biznesi bënë presion por insistoi që këto leje mos të epen nga lartë. Inspekcioni nuk e kryen punën e vet, ndaj përnjëherë shfaqen ndërtimet nëpër zona rurale etj.

Afërdita Berisha në vazhdim propozoi që të fokusohet debati në pyetjen pse nuk zbatohet ky ligj dhe si duhet të zbatohet në të ardhmen.

Përfaqësuesi nga Vushtrria mendoi se ky komision parlamentar dhe Kuvendi gjithashtu duhet të kërkoi nga kryetarët e komunave një gjë të tillë, zbatimin e ligjit dhe ndalimin e destinimit të tokës bujqësore, ndërsa ministria e bujqësisë të kërkoj harmonizimin e planeve zhvillimore komunale me ligjin në fuqi.

Përfaqësuesi nga Gjakova mendoi se shkak i moszbatimit të ligjit janë zbrazëtitrat që i ka, nuk ka organe që ekzekutojnë, nuk funksionojnë mekanizmat, ligjet po hartohen shpejt, komunat nuk kanë plane për zonat rurale, ndërsa në anën tjetër njerëzit dëshirojnë zgjedhje për shkak se duhet

të gjallërojnë. **Nait Hasani** nuk u pajtua me parafolesin ngase fjalët e tij tingëlluan më tepër politike, ndaj pyeti konkretisht për gjendjen në Gjakovë dhe ndërtimet që bëhen atje në ca vende. Përfaqësuesi tha se Gjakova nuk përfshinë sipërfaqen prej Krushës së madhe dhe mbeti pranë qëndrimit se inspekcioni, gjykata nuk funksionojnë si dhe ministria me komunën duhet më mirë të koordinohen.

Përfaqësuesi i AKP insistoi në gjetjen e fondeve për plane hapësinore ngase ky institucion nuk mund të mbroj sa duhet tokën. **Sevdije Lama** insistoi të sqarohet çështja e tokës së Erenikut dhe pyeti MB-në pse AKP thotë se janë 6000 ha djerrinë ndërsa komuna thotë 600, për çka përfaqësuesi tha se komuna ka faj ngase nuk ka bashkëpunim rreth komasacionit si dhe gjendja është alarmante. Ky institucion menaxhon me tokat shoqërore të cilat i nënshtrohen të gjitha planeve komunale, por kot, ndaj është kërkuar ndihmë nga ministria.

Nijazi Idrizi potencoi nenin 44 për komunat që nuk kanë plane dhe të cilave nuk u jepen pëlqimet nga ministria për ndryshimin e destinimit të tokave, ndaj konstatoi se ligjet duhet të lexohen me vëmendje. **Përfaqësuesi tjetër i ministrisë së bujqësisë** tha se ligjet duhet të determinohen kah do të marin kahjen ngase gjendja është alarmante ngase ministria dëshiron ritjen ekonomike por duke planifikuar. Problemi tjetër është edhe çështja se ky ministri nuk ka përfaqësuesin e tij në AKP çka është një domosdoshmëri ngase duhet një orientim më i veçantë në politikat e privatizimit. Sa i përket shfrytëzimit të zhavorrit ky ministri aty nuk ka kompetenca. Sugjeroi që institucionet të alarmohen për planet rurale me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore.

Përfaqësuesi i Gjakovës nuk e kuptoi qëndrimin e cekur alarmant ngase tokat e Erenikut menaxhohen nga AKP e jo nga komuna dhe insistoi se kjo është një dezinformatë. **Përfaqësuesi i AKP** tha se i vjen keq për këtë polemik e cila tanimë kaloi në taborin personal, por përsëriti se “në Gjakovë vazhdon puna e komunës pa pëlqimin tonë dhe nuk ka bashkëpunim për komasacion”. Pasi që përsëriti pyetjen **Sevdije Lama** për disharmoninë e të dhënave për sipërfaqe të papunuar, **Shefki Zeqiri** tha se ministria nuk mund ti detyroi pronarët të punojnë tokën, ndërsa për tokën shoqërore përgjegjësinë mbanë AKP.

Përfaqësuesi i Klinës tha se djerrinat duhet të eliminohen nga Komunitat, psh. në Pejë nuk epen kontratat për fermer për subvencione, të epet pëlqimi nga ministria e jo nga komuna, kjo nuk shkon.

Pasi që **Nait Hasani** sqaroi çështjen e Gjakovës dhe Rahovecit rreth territorit se kujt çka i përket (përfaqësuesi i Gjakovës tha se vetëm andej Drinit është e Gjakovës), **përfaqësuesi i Rahovecit** tha se problemi qëndron te mekanizmat e veprimit siç janë komisioni për miniera e minerale. Në vazhdim ishte debati më i hollësishëm rreth ndërtimeve në mes këtyre dy komunave, ndërsa **përfaqësuesi i Fushë Kosovës** pyeti kush merr përgjegjësi për statistika joreale. **Afërdita Berisha** lidhur me këto statistika tha se duhet bërë databazën e saktë.

Përfaqësuesi i Pejës insistoi që mos të vazhdoi debati në këtë drejtim ngase duhet të dihet kush është përgjegjës (kompetent) për të gjitha dilemat e parashtruara lidhur me këtë ligj, ngase padyshim në fund dikush del fajtorë. Shpesh potencohet fajësia e drejtorive komunale, ndërsa nuk thuhet se inspekcioni është i ndarë nga këto drejtori. Ai tha se në komunën e tij gjithmonë takohen përgjegjësit kryesorë një herë në javë në shërbimet këshillimore, ndaj kështu duhet të veprojnë edhe tjerët, kjo do të ndihmonte në gjetjen e personit përgjegjës.

Nijazi Idrizi pyeti të gjithë pjesëmarrësit pse nuk zbatojnë nenin 8.3 ku kërkohet që komunat të mbajnë evidencën për tokat bujqësore dhe ti dërgojnë ministrisë në bazë të kërkesës së saj, dmth komunat nuk kanë kryer obligimin lidhur me faktin se çka ka ndodhë me tokat bujqësore në komunat e tyre. Ai potencoi dy tre komuna të cilat e kanë kryer këtë obligim. Prandaj konstatoi se përgjigjet e komunave në pyetësin e parashtruar janë gati qesharake. **Sevdije Lama** gjithashtu pyeti si mendojnë komunat të risin buxhetin e tyre nëse tolerojnë vazhdimin e gjendjes së konstatuar në këtë takim. **Shefki Zeqiri** duke u përgjigjur në fillim tha se ministria nuk mund të detyroi pronarin të jap me qira tokën e tij por vetëm mund të inkurajoj, ndërsa përsëriti edhe një herë apelin :”komunat duhet më tepër të bashkëpunojnë me ministrinë”.

Përfaqësuesi i Istogut tha se djerrinat eliminohen me organizim më të mirë dhe tregoi shembullin nga ky qytet, që tregon se plani rregullues nuk bënë të tejkalohet përtej vijave të trasha.

Përfaqësuesi i Agjencisë nga Statistika propozoi komisionit të rekomandoj edhe regjistrimin në bujqësi dhe për plane rurale, ndërkaq

Nijazi Idrizi konstatoi se këto plane rurale duhet të jenë pjesë e planeve komunale, përndryshe në përmbyllje falënderoi pjesëmarrësit duke konstatuar dhe shpreh pakënaqësinë me gjendjen ku jemi me tokat bujqësore, ngase në vend se të prodhoi vendi ynë ushqim, ai duhet të importoj 500 milion euro në vit për shkak se ne nuk mund ta zbatojmë ligjin për tokën bujqësore. Tjetër problem që u vërejt në këtë takim, tha se është moszbatimi i planeve zhvillimore nga komunat si dhe obligimi i ministrisë së bujqësisë për të mbledhur të dhënat dhe të propozoi politikat e zhvillimit, përndryshe del se nuk e duam këtë vend.

Nait Hasani u bashkëngjit falënderimit dhe njoftoi se komisioni së shpejti do të nxjerr rekomandimet për Kuvendin e Kosovës lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani